


BIBLIOTEKA
SHTETIT

BJH-7

525

VANGJUSH SARO

Prolog satirik



8JH-2

525

VANGJUSH SARO

Prolog Satirik

Skica satirike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

AI DHE... PIKELLIMI

Bisedën e hapi ai:

— Ke ndonjë pyetje? — më tha.

— Po — i thashë. — Një...

— Hë folë!

— Më thuaj pse je kaq i pikëlluar.

— Pse, dukem?

— Po, ...

Pauzë. E shkurtër. Ai shpërtheu:

— Pikëllimi im, i dashur, justifikohet shumë thjesht. S'kam turp të them se ai e ka zanafillën ditën që u transferova këtu. Ky qytet është mikroskopik...

Ai fliste me zë të ulët, të ngjirur.

— Mos u mërzit, — i thashë befas — do të mësohesh...

Ai u bë edhe më i zymtë. Kapsalliti sytë disa herë me radhë dhe:

— Mor po, ç'kujton ti? — Sa nuk më pështyu. — Ç'kujton ti, se do të pajtohem me këtë situatë? Unë...

...Bëra një hap prapa. Ai më kapi për krahu.

— Dëgjo...



Dhe filloi të më përsëriste arësyet, për të cilat ishte i pikëlluar.

U ankua për gjithshka. Për kino-teatrin, për dyqanet, për bulevardet, për klubet, për klimën, bile bile edhe për rrojtoret.

Më në fund u ndamë.

Ai u largua i kënaqur që kishte mundur të përmbante lotët.

Unë u plasa mbi divan dhe, për të harruar imazhin e syve të tij aq të pikëlluar, fillova të shfletoja koleksione gazetash. S'mbaja mend se ku kisha

lexuar dikur një prej artikujve më të fortë të tij, shkruar në T... Kërkova rreth gjysmë ore dhe e gjeta. Artikulli titullohej: «Asnjë tendencë rehatie, asnjë pretendim!»

Më erdhi ta grisja. Po autori mungonte. Do të dëshiroja ta bëja këtë para syve të tij, aq të... pikëlluar.

NATËN E MIRË, SHOKU KOZMA!

Nata kishte mbuluar prej kohësh çatinë dhe rruçicat me çarçafin e heshtjes. Ata kishin mbështetur kokën mbi jastëkët e bardhë dhe s'flisnin.

Nata ishte e thellë, e zezë, aq sa atij i dukej sikur diçka e errët hynte vazhdimisht e me këmbëngulje nëpër dritaren e hapur. Ishte i shqetësuar. Gjumi që atij i dukej vazhdimisht si një fëmijë te kanjuz, i keq, i pabindur, ndodhej ende larg.

— Natën e mirë! — i tha gruaja.

— Hë?

— Natën e mirë!


— Natën e mirë?.. — Ai lëvizi me mundim duke dashur të ngrihet në bërryle.

— Natën e mirë... tën e mirë... rë... (s'mbaj mend a i thashë «natën e mirë» shokut Kozma?)

Vetëm tani e kuptoi pse ishte aq i shqetësuar. «Mendjemadh! i sokëlliu vetes. Mendjemadh, ja ç'je... E çfarë i kushton njeriut një frazë e tillë? Asgjë. Dhe shumë njëkohësisht. Shumë, sepse shoku Kozma, shoku Kozma... zma...»

Gruaja kishte filluar një goxha recital me gërhim.

«Çudi, sa e qetë, filozofoi ai, ka njerëz si kjo,



që s'e vrasin mendjen, janë apo s'janë. Por mos vallë po nxitohej? Mos vallë e kishte përshëndetur dhe tani po e gërryente ndërgjegjja më kot? Ah, jo! I kujtohej mirë. Po numëronte lekët për cigare... Kur shoku Kozma kishte kaluar paksa majtas. Ai kishte menduar t'i fliste, por... shoku Kozma ishte tepër larg. Ai ishte lëkundur. Pra jo...

«Mendjemadh! i bërtiti edhe një herë vetes. Dhe kërkon pastaj respekt, nder, ti që s'përshëndet as eprorin... Dhe tani gjithshka vjen e zbehet. Shoku Kozma mendon për mua si për një pa... palaço e, kur vjen rasti, i thotë edhe drejtorit: «I mirë, i mirë, por kur s'të respekton...»

Gruaja vazhdonte të gërhiste. Ja edhe kjo ishte pak a shumë mungesë respekti.

«Ç'do të thotë «gëer...»? (Edhe në gjumë duket njeriu pa edukatë».)

— (Gër...)

— Po mjaft pra, pusho! — bërtet ai.

— (Gër...)

— Natën e mirë, shoku Kozma!

— (Gër...)

— Oh, natën... shoku Kozma! (shkon kështu)?

— (Gër...)

— Pushoooo!

* * *

Në mëngjez pa fshirë ende buzët gjithë kafe ai vrapon te stacioni i urbanit. Përplasat atje me një plak, pastaj me konduktoren dhe më në fund me shokun Kozma që është ulur në sedilje.

— Natën e mirë, hm... mirë mëngjez, shoku Kozma!...

AUTORITET DHE AUTORITET

Ishte duke dëgjuar një valc sinfonik, kur ndodhi «hataja» (siç e quajti ai). Në bulevardin kryesor i zunë sytë Zelihane, gruan e tij. Ajo po ecte qetë-qetë mes dy burrash të panjohur, të cilët atij iu dukën shumë antipatikë. U ngrit në këmbë dhe përplasi me sa mundi në tryezë grushtin. Mos i bënin sytë? Si ishte e mundur të ndodhte kjo?

Pak nga pak gjaku i hipi në kokë. Filloi të vërtitej nëpër dhomë i nevrikosur, S'kaluan veçse disa minuta dhe dera, ashtu si zakonisht, u hap ngadalë e me kujdes.

— Mirë dita! — tha, Zelihaja. — Paske ardhur?

— Kështu sikur duket — tha ai me ironi.

— Hë, ç'kemi? — vazhdoi ajo.

Ai tkuri vetullat, shëmtoi me zor buzët dhe heshti.

— Mora bileta për në teatër — tha Zelihaja.


— Si?!

I shpëtoi kjo pyetje... Nuk mund të përmbahej. Kjo ishte thjesht paturpësi. Ajo kishte nuhatur pararojën e zemërimit të tij dhe donte të tregojë qetë, e këndshme. Po kujt donte t'ia hidhte se...

— Ku i ke biletat? — pyeti ai befas.

— Ja. Shfaqet një komedi e bukur. . .

Ai ia rrëmbeu biletat dhe me një stil të çuditshëm i grisi aty për aty, pa humbur kohë.



— Shko vetë! — i sokëlliu. — Rrugën për në teatër e di. Shokë, ke. . .

Zelihaja u skuq dhe ia nguli sytë me inat.

— Këtu e paske pasur hallin. Unë thashë se ku do dilje. Po ata janë kolegët e mi — u ankua ajo. — Ti e di këtë.

— Mjaft — ia ktheu ai autoritar. — Nuk më duhet ç'janë ata.

— Asllan, nuk të ka lezet.

— Ashtu? Po ç'gjë më paska lezet atëhere? Që të shoh gruan me të tjerë dhe të hesht?

Ç'është e vërteta nuk vazhdoi më gjatë. Me kaq e mbylli.

Autoriteti e kishte ndihmuar në një situatë të koklavitur.

Kaluan ditë.

Autoriteti i tij nga dita në ditë po bëhej më olimpik, por pikërisht në kulmin e lulëzimit u tro-ndit dhe pësoi traum.

Një pasdite po kthehej prej zyrës së bashku me dy shoqe. Dukej i gëzuar dhe kishte vendosur të pajtohej me Zelihanë. «Të shkuara, të harruara», mendonte duke ngjitur shkallët. Hyri në apartament gjithnjë i qeshur dhe përshëndeti qysh në para-dhomë:

— Mirdita!

(Po si do t'i thosh tani: «Të shkuara, të harruara»?)

Një pauzë.

— Mirdita — tha sërish.

Një pauzë tjetër, më e gjatë. Ai u kollit.

— Zeliha, dëgjo, çfarë ke? Kam marrë dy bileta për në kinema.

— Si?!

Ishte Zelihaja ajo që kërceu. Dhe, pasi i tkuri vetullat, ashtu siç bënte shpesh ai, vazhdoi me thumb:

— Shko! Rrugën e di. Shoqe, ke...

— Qysh?

— Ja kështu.

— Hë! — dhe donte të shtihej i nxehur, por s'mundi. — Nejse — tha — nejse, të shkuara të harruara. E kam atë drejtë zakon, që nxehem për hiç gjë po ama dhe më bien shpejt inati. E si thua?!

— Mor, po vërtet ke filluar të ndryshosh! S'je më ai i pari.

TRI DITË ME SOKOLIN

Duke hyrë në dhomë Saliu ndeshi befas në një skenë tronditëse. Djali i tij i vetëm, Sokoli, ishte ulur në divan e po qante i lebetitur. Kurse pranë tij qe e shoqja, që po e qortonte. Zëri i saj ju duk i vrazhdë dhe i rreptë. Kjo gjë e ftoi edhe atë në skenën e grindjes.

— Moj, po pse i bërtet xhanëm? — pyeti ai rru-feshëm.

E shoqja, me të ndeshur shikimin hetues të bu-rrit, u mërziu edhe më tepër...

— Nuk po i bërtisja, por po e këshilloja. Sokoli sot ka bërë faj. Ka thyer tërë gotat e kompletit të ri.

Saliu qeshi, u qetësua dhe mori përsipër rolin e arbitrit.

— Ti, grua, i zmadhon gjërat, — tha ai tek pa që ja mbyti kot dhe për ta rregulluar mendimin që tha më lart vazhdoi: — desha të them, se kjo nuk është aq shqetësuese. Nuk u bë qameti, de... Në fund të fundit mund të blejmë të tjera, se gota janë. Kurse djali është... djalë. Dhe a mendon apo jo që e kemi të vetëm?


E shoqja e vështronte e habitur.

— Pastaj, — vazhdoi Saliu, duke përqafuar Sokolin e tulatur, — edhe në qoftë se i ka thyer, këtë e ka bërë krejt padashur, apo jo?

Sokoli filloi të lëvizte. Ai çonte vazhdimisht duart lart në shenjë gëzimi.

— Pastaj, pastaj, ti e sheh se ky është i urtë. Sa nis dhe e kritikon preket kaq shumë sa fillon e qan me ulërima — e deformoi zërin Saliu. — Ky nuk meriton të shahet. Dakord!, kolopuçi i babit!

... Të nesërmen, sa hyri brenda, vuri re se po përsëritej skena e ditës së kaluar. Gruaja po i fliste të birit. Kësaj radhe më me nerva.



— Po pse, o Sokol! Pa shih ç'bëre, o i uruar!
— Ç'ka ndodhur xhanëm. Sa herë vi në shtëpi të gjej duke qortuar djalin.

— Të lutem, Sali. Kështu si vepron ti, nuk na

ndihmon as mua as djalin. Ai prapë sot theu shishen e bojës dhe fare kot.

— Sokoli?! Posi, posi. Harron ti se ai do të luajë, dhe se duke dëmtuar, ai luan; duke luajtur, bëhet më çapkën, më simpatik. Këtë e thotë dhe pedagogjia.

Gruaja hapi sytë. Ajo shikoi edhe një herë Sokolin që nuk fliste fare dhe iu kthye Saliut:

— Ti po e dëmtton Sokolin. Unë nuk di si të veproj. Sokoli gjeti mbështetje te ti dhe nuk i dëgjon më këshillat. Madje, ka filluar të mos ketë as respekt për fjalën time.

— Ua pse s'thua? Po kjo qenka e tmerrshme! Saliu për një çast qëndroi në mëdyshje e pastaj vazhdoi:

— Ka thyer shishen e bojës mbi qilim, e pastaj u bë gameti.

Pas kësaj mbrojtjeje të çuditshme Saliu iu afrua të birit. Buzët i kishte në formacion puthjeje. Po befas ndërroi mendje. Dhe ja pse gruaja duhej sqaruar.

— Ti the se... filloi ai.

— Nejse e lemë këtë bisedë dhe e vazhdojmë një herë tjetër kur të jemi të dy — tha gruaja që nuk dëshëronte që skena të tilla të zhvilloheshin, në prezencën e Sokolit, po Saliu nuk e prishi terezinë. Pasi nuk harroi ta puthte Sokolin, i tha:

— Mamaja, xhan flet shpesh në tym. Po ti mos u mërzit. Bile kur mamaja të qorton, ti mos hesht. Këndo! Sa për kutinë e bojës, blejmë një tjetër.

* * *

Kështu u rrokullisën ditët, derisa ndodhi ajo që s'ishte parashikuar prej Saliut. Kur hyri në shtëpi,

vuri re se e shoqja qe mjaft e mërzitur, sa që fytyra i qe skuqur gjer te veshët. Ndërsa për çudi nga dhoma tjetër vinte melodia e një kënge fëmijësh: «Më në fund Sokoli, e paska kuptuar,» mendoi Saliu.

— Hë, — i tha gruas — ndonjë bisht pene?

— Jo... Sokoli prishi radion.

— Si?!

— Po, po. Prishi radion.

— Mjaft! — Sokëlliu ai. — Po çmendem. S'është e mundur të vi një ditë në shtëpi e të mos dëgjoj ankesat e tua për Sokolin. A është e mundur?...

— I fola, po s'më dëgjoji fare — u shfajsua gruaja.
— Kishte krah të atin.

Ky thumb e preku Saliun. Psherëtiu thellë. Iu afrua radios. Nuk mund të përmbahej. E çoi grush-tin lart, e rrotulloi disa herë dhe pastaj e përplasi me zhurmë mbi të. Për çudi ajo buçiti disa herë «flu, flu,» dhe filloi të transmetonte muzikë.

— S'do të blejmë një tjetër? — pyeti Sokoli me interesim duke hyrë në kuzhinë sapo që kishte dëgjuar zërin e të atit.

— Jo. E pse? Kjo u rregullua — tha Saliu që befas u gëzua pa masë dhe, pasi mori edhe një herë frymë thellë e pasi e shprehu me ca lëvizje të çuditshme tronditjen e tij, i tha gruas me seriozitet: — Po ti ke të drejtë. Duhet vepruar sa pa u bërë vonë.

DJALI I PROFESORIT

Ata u takuan para xhameve plot avull të rostiçerisë. Çeti ndjeu një grusht përkëdhelës në shpatull. E kishte përshëndetur Cani.

— E, ujk, ç'bën?

— Hiç...

— Ashtu?

— Ashtu...

— Do një cigare?

— Çfarë, «Partizan»?


— E pse, s'të pëlqen?

Ata ndezin cigaren dhe mbështeten te xhamet e rostiçerisë. Në rrugë ka ende pak njerëz dhe ata s'dinë me çfarë të tallen.

— Ou, një zgërdalace — thotë befaz Çeti duke treguar një vajzë.

— Hop! — Cani i ka vënë asaj këmbëzën. Vajza lëkundet, skuqet, por nuk rrëzohet dhe Çeti, që priste ndonjë gallatë, shan nëpër dhëmbë: «Sentimental!» Tjetri qesh. Ata rroken befaz dhe shkojnë nga njëri cep i trotuarit te tjetri duke u lëkundur, gati të rrëzohen nga çasti në çast.

— Ooo! — befaz ata janë përplasur me një pla-



kë që ndodhet tani përtokë. Dy shishe me qumësht
i thyhen duke ia bërë të bardha rrobet e zeza.

Plaka mallëkon, por ata largohen pak më tej
dhe atje qeshin me të madhe. 32 dhëmbë jashtë...

Pastaj? Ata diskutojnë për boksën, pastaj për
Lamin që qenka bërë «hero» karikaturash në qendër
të Tiranës.

Tani e ndezin edhe nga një



Pas një çasti heshtjeje dy burra kalojnë para tyre. Njëri kërkon të nderë cigaren. Ata i tregojnë njëri-tjetrit... Tallen. Më në fund Cani vë dorën në zemër dhe ia nderë. Burri largohet.

— Ç'maskarenj! — i thotë ai burrit tjetër. — Ai i gjati është i Ymerit, i atij profesorit. Ai edukon të tjerët... i biri bredh gjithë ditën si rrugaç.

* * *

Është errur dhe njerëzit në rrugë janë rralluar. Ata të dy në rrugë, mbështetur pas murit të një ndërtese, zgërdhien krejt pa shkak. Tani ata shpeshojnë cigaret. Befas vjen thujse me vrap Lami, ai «heroi» i fletërrufesë. Duket i lodhur dhe shumë i shqetësuar. Mezi belbëzon diçka për një fletërrufe të vënë nga nxënësit e gjimnazit, në të cilën i paskan nxjerrë edhe me fotografi dy shokët tanë. Dhe ku? Në mes të qytetit. Çimi ngrihet në këmbë. Nuk duket më në fytyrën e tij ai gazi i papërmbajtur i të 32 dhëmbëve. Diç u thotë shokëve dhe të tre nisen nga ka ardhur bukuroshi i tretë. S'flasin. Nxitojnë. Me sa duket u tronditën mirë...

FEJTONISTI BETOHET...

...Dy burra të veshur me pardesy çapiteshin rëndë-rëndë nëpër shi e erë. Kohë e keqe. Rreth e rrotull errësirë, ujëra, pellgje të ndyta.

— A e sheh? — shfryu i pari, një gjatosh, fytyra e të cilit shprehte ankim.

— Posi — iu përgjegj tjetri duke lëvizur me përtesë trupin e rëndë, trashalug. — Por është e pamundur.

— E pamundur? Po... ti je fejtonist.

I trashi heshte. Në fytyrën e tij kishte zënë vend shprehja: «Më lërë rehat.»

Po i gjati nuk thyhej. Ai vazhdonte të kthehej nga shoku dhe të argumentonte:

— Çfarë do të shkruash në fejton? Dëgjo, pallati u ndërtua, po ndërtuesit e tij e lanë punën në mes, ose më sakt, përsa i përket pjesës tjetër të punimeve, u treguan neglizhentë. Mbeturinat në tulla, gurë, dërrasa e sidomos ujërat e dherat u harruan rreth e rrotull pallatit. Kur bie shi, ky pallat duket si ato kështjellat mesjetare që ndërtoheshin mes ujërash... Duket romantike, po është tragjike. Kalimi aty merr formën e një problemi të vështirë..

— Ty nuk të mungon fantazia — vërejti i trashi (apo fejtonisti). Por unë jam shumë i zënë, kupton?

- E di, po...
- Jam shumë i ngarkuar, kupton?
- Dakord, po...
- E pamundur, kupton?

I gjati u hutua.

Kështu, duke e hequr zvarrë këtë bisedë të mërzitshme, dy burrat iu afruan më në fund objektit, për të cilin diskutonin. Pallati nr. 18. Ky pallat i heshtur, i mbytur me të vërtetë në ujëra, tani shtrihej para tyre si diçka e zezë, e pakapshme nga larg.

— Shiko përpara! — komandonte i gjati.

Tjetri llapashitej me frikë. Herë-herë shante nëpër dhëmbë. I gjati i shkante pas.

...Erdhi një çast dhe i trashi mbeti midis një formacioni të lëngët balte dhe u çimentua aq keq, sa nuk lëvizte fare.

— Hë, — i tha i gjati — ç'pate?

Tjetri filloi të lëvizte, por... kot.

— Hë, ec! — i foli gjatoshi përsëri, duke u kthyer nga ai.

— S'mundem.

— A e di çfarë? Lëviz fort, shumë fort!

I trashi tentoi sërish.


— Zor — mezi munda të shqiptonte.

— Më fort, më fort!

Natyrisht shpëtoi...

Po pallati ndodhej akoma larg. Ecën vetëm disa hapa dhe përsëri diçka... Duke dashur të kryejë një kërcim të rastit, i trashi humbi ekuilibrin dhe u rrëzua në një goxha pellg gjithë ujë e baltë. I gjati klithi. Pas disa përpëlitjesh i trashi u çua.

Kur trupi i tij rifitoi pozicionin vertikal, ai nuk njihej pothuajse fare. Ishte përbaltur e ndotur



si mos më keq. Prej fytyrës i rrëzoheshin pa ceremoni pika uji. Mbërritjen e tyre në shkallë e pritën me interes gjithë banorët e shkallës. Gjithkush pyeste, kërkonte intervistë.

Por fejonisti, duke çarë me trupin e trashë e të lagur e duke ngritur lart pa kuptim dorën e përballtur, bërtiste:

— Më lini rehat! Do të shkruaj një fejton. . . të tmerrshëm.

LUTET BABAI «IDEAL»


I dashuri, i shtrenjti dhe i paharruari, miku im Aleks!

Po marr guximin t'ju shkruaj për një problem që po më ha shpirtin së gjalli. E dini se im bir, Xhevahiri, po mbaron klasën e parë të shkollës së mesme? E dini se... (dhe pikërisht kjo është katastrofa) po e mbaron pa sukses?

E dini madje se pas një varg hallakatjesh sqaruese nxora në dritë një përfundim gjenial? (Sipas këtij përfundimi mësuesit janë fajtorët numër një dhe unë... absolutisht i pafaj).

...Një ditë takova mësuesin e historisë. Fillova t'i parashtroja dyshimet e mia rreth vlerësimit abstrakt që i bëhej Xhevahirit tim. Ai e parandjeu stuhinë, prandaj më foli plot elokuencë e muzikalitet. Rrjedhimisht edhe unë e ndërrova tonin. Por befas ai filloi të errësonte meritat e fëmijës sime. Bile nuk pati turp e më tha: «Është i dobët. I mungon vullneti.» Po kujt i fliste kështu? E dinte se... në fund të fundit isha një baba ideal? Atëhere vetëkuptohet, iu ktheva dhe e bombardova. Natyrisht me fjalë «përkëdhelëse».

...Një ditë tjetër u përlesha me mësuesin e ma-



tematikës. S'mund të duroja pa i dhënë edhe atij vendin që i përkiste. Ky m'u duk shabllonist. Më tha se... Po kjo s'ka rëndësi. Rëndësi ka që unë ia fillova një ligjërate me funksion të dyfishtë: sqarues dhe ofendues. Kjo veç mbushi kupën.

I bindur se mësuesit ishin të vetmit fajtorë të

përparimit negativ të djalit, kërkova shpërnguljen...

Çregjistrim dhe reregjistrim.

Në shkollën tjetër, pas disa ditësh të lumtura, më thirrën në këshillin pedagogjik. Përsëri nota negative.

Atëhere i vura gishtin kokës dhe e mora çështjen më seriozisht. Po në fund të fundit mbërrita në konkluzionin se im bir, (si edhe unë), ishte jo vetëm i pafajshëm, po edhe viktimë. Fajtorët? do të pyesësh ti. Mësuesit. (Ah, faktori mësues!). Mendo, në tërë klasën vetëm ky ishte mbetës.

Shkurt, një ditë kërkova urgjentisht shpërnguljen e dytë.

Riçregjistrim e...

Eh, mik! Më beso, im bir po mbetet në klasë dhe unë thuajse po vdes. Tani që e mësove tragjedinë, dëgjo edhe lutjen fatale të një babai. Drejtori i shkollës, ku im bir është prezent, është kushëriri i parë i gruas suaj. Ç'lumturi! Ai (drejtori) mund...

Ju lutem, i dashur Aleks, ndërhyuni. Me respekt, deri në triumfin e çështjes sime.

I juaji

Sh...

Priti e pritni përgjigje, po në vend të saj i vajti dëftesa e të birit me nota pakaluese.

NË KLUBIN E KOOPERATIVËS

Ky lokal i thjeshtë, me pak karrige e stola, me një banak të modës e një bufetier të çuditshëm, që ngjan më shumë me një këpucar, është pikërisht klubi i kooperativës N...

Ky burrë i shkurtër me peliçe krahëve e llullë në gojë është kryetari i kooperativës. Kurse ky tjetri që flet vazhdimisht dhe kollitet vend e pa vend është pjesëmarrës i një grupi diletant që ka ardhur mik në fshat për të shfaqur numrin estradesk «Emancipimi i gruas».

Të dy pinë duhan dhe bisedojnë.

— Në përgjithësi fshati juaj është i bukur — thotë diletanti me teatralitet.

— Dhe punëtor — shton kryetari.

— Natyrisht...

Bëhet një pauzë e shkurtër. Pastaj diletanti thotë:


— Mund t'ju pyes...

— Posi.

— Ku jeni me... emancipimin e gruas?

— Në ballë...

— Mos vallë e teproni? — thotë diletanti dhe kollitet sikur të ishte në rol.



- Jo. Jemi me gjithë mend shumë mirë...
— Si ia arritët?
— Me luftë.
— Qysh? Po shifrat ç'thonë?
— Rreth 25 të reja i kemi nisur për dy muaj në një aksion lokal...
— Kaq?
— Jo. Dy të reja dhe një grua janë zgjedhur në kryesi.
— Kaq?
— Jo. Dy të tjera i kemi brigadiere.
Përsëri pauzë.
Diletanti bën ca gjeste me duar. Kollitet.
— Megjithatë, o kryetar, qenkeni prapa. Koha po ecën me hapa kilometrike. Po bëhen çudira.
— E di. Po ju sa veta jeni në grup?
— Plot 19...

— Sa vajza keni?

— Asnjë... më falni... një...:

Kryetari qesh me zhurmë. Tjetri nuk vonon të shfajësohet:

— Duhet marrë parasysh se puna jonë është delikate. Çështje talenti, pak e komplikuar...

— Natyrisht — dhe kryetari babaxhan nuk flet më...

NË PRITJE...

— Ju kuptoj mirë, po difekti është shumë delikat — i thoshte shefi i repartit, një mesoburrë, me një fytyrë të ngjallur, të parruar një punëtori.

Punëtori i shkante pas me duar në xhepa. Shefi vazhdonte:

— Ti do të thuash se K... ndodhet fare afër dhe se muzeu është i mrekullueshëm? E di. Do të thuash se kjo ka të bëjë me edukimin e punonjësve? Edhe këtë e di. Po çfarë t'u bëjmë shokëve të komunikacionit? Nuk e mbajtën fjalën.

— Si do të bëjmë tani? — pyeti punëtori duke treguar punëtorët. — Ata janë përgatitur për eskursion, por...

— Hëpërhë le të presim.


— Domethënë të mos fillojmë punën? Në rast se anulohet eskursioni, do të punojmë te ndërtesat. Apo jo?

— Jo!

— Pse?!

— Jo! — tha përsëri shefi. — Nuk na ha kurri-zi për kritika. Gjithmonë na kanë hequr veshët se nuk tregojmë kujdes për argëtimin e punonjësve dhe kanë pasur të drejtë, por që sot e tutje s'do të gjejnë më shkas për të na kritikuar. Sot është

planifikuar eskursioni në muzeun antik të qytetit K... dhe pikë. Kjo do të bëhet medoemos. Kupton? Unë s'jam aspak teknokrat. Kupton? Tani... në pritje.



Punëtori kryqëzoi krahët dhe u largua. Shefi rrëmbeu receptorin.

— Këtu. Uzina mekanike. Alo? Nuk keni automjet? Po ju na premtuat të presim akoma? Bukuri! Ne do vazhdojmë të jemi... në pritje.

Shefi u ul dhe ndezi një cigare. Kush tha se ai s'e vinte ujin në zjarr për argëtimin e punonjësve? Ja tek po bëhej copë. Kishte planifikuar për këtë

një ditë të tërë. Argëtimi i punonjësve është apo jo një problem me rëndësi?

Shikonte tymin e cigares dhe mendohej. Dalëngadalë i mbeti midis gishtave vetëm bishti. E flaku atë dhe ndezi një cigare tjetër. Edhe kjo u bë dalëngadalë hi. Shefi ngriti përsëri receptorin.

— Alo? Unë... Po. Shpejt? Po a e dini se ora është 9? Akoma të presim? Po hë!

U ngrit në këmbë. Pastaj sërish u ul. Ndezi përsëri një cigare. Po sikur të mos e humbnin kohën kot? Sikur të ngarkonte atë punëtorin ezmer t'u mbante punëtorëve ndonjë leksion për... Sa budalla po tregohej! Ç'i duhej atij kjo fantazi e çuditshme? Mjaft po copëtohej, cigare, receptor. Pas pak u dëgjua zilja e telefonit.

Hop! kërceu shefi.

— Po. Kur? Në orën 11? Hm... po është me të vërtetë i lirë autobusi? Ashtu? Në rregull atëhere. Ne jemi gjithmonë në pritje.

Pra autobusi do të vinte rreth orës 11. Pak me vonesë, po kjo s'kishte ndonjë rëndësi të madhe.

Ai u ngazëllye një çast. Doli prej zyrës. Donte të takonte atë punëtorin ezmer dhe t'ia thoshte bisiden e fundit që pati me atë të agjencisë. Po nëpër repart nuk i zuri syri asnjëri. U kthye prapsht. U ul përsëri në kolltukun e dashur të zyrës dhe ashtu e kapi një gjumë i gjatë, i magjishëm.

* * *

Zilja e telefonit kumboi për të tretën herë. Shefi u përmend. Shikoi orën, 11.30.

— Oh! — tha dhe sa nuk kafshoi receptorin.

— Këtu. Çfarë? Ju lutem çfarë thatë? Nuk do të dërgoni autobus? Po si është e mundur?

Shefi doli prej zyrës. Nëpër reparat asnjë lëvizje. Asnjë zhurmë. U habit.

Vrapoi nëpër oborrin e heshtur të uzinës. Pa punëtorin ezmer që po i afrohej. U takuan:

— Hë...

— Tani sapo bisedova përsëri me ata të agjencisë së autobusave.

— Asgjë?

— Jo. Eh, ashtu, ashtu...

— Domethënë, asgjë!

— Po, po. Eskursioni dështoi.

— Po për çfarë arsëye?

— ...

— Sa keq, shef!

— Mungesë autobusi. Plani ynë ishte shumë i rregullt. Ne domethënë...

Ndërkaq ezmeri i tregoi me dorë ndërtesat përballë uzinës.

— Ata janë atje — tha.

— Ashtu?

— Po punojnë qysh prej disa orësh.

— Ashtu? — tha përsëri shefi.

Punëtori nënqeshi. I zgjati një cigare.

— Sa më vjen keq që pritëm kaq tepër! — foli shefi duke u përtypur me zor.

— Ah, mua jo, — e qetësoi me ironi punëtori — sepse të paktën... pritëm... duke punuar.

HISTORIA E SHKURTËR E NJË RUBINETI

Zhurme, zhurmë, zhurmë. Të përfytyrosh një mizë brenda hapësirës së një gypi. Boshllëk. Miza vërtitet dhe bën zzz...

Vërtitet edhe Nishani si në qyp mbledhjeve. Zhurmë. Betime e zotime.

— Unë... domethënë ju... s'më njihni, unë do të bëj atë që s'e bën dot asnjë. Vërtet erdha dje me vonesë dhe u kapa me drejtorin, po unë... domethënë ju s'më njihni... po do ta shohin kush është Nishani. Do të bëhem shembull, yll ndriçues për të gjithë.

Dhe s'kalon shumë. Nishani përsëri gabon. Këtë herë s'vjen me vonesë, por fyen një shoqe dhe është gati ta kërcënojë edhe me forcë. Rubineti Nishan hapet dhe...

— Unë... domethënë do ta tregoj me fakte kush jam, domethënë do ta bëj praktikë atë që them. Se unë vërtet bëra një gabim të vogël, diçka si... skandal, por kjo s'do të thotë se unë, domethënë do të vazhdoj kështu. Unë do të ndryshoj rrënjësisht, do të bëhem yll për të gjithë... Domethënë e ndjej gabimin, po unë...

Dikush tha atëhere: «Nishani si miza në qyp.»
Dikush tjetër tha se mund të thuhej dhe fare shkurt:
«Si Nishani në qyp.» Po rubineti përsëri u fal. Dhe
Nishani vazhdonte në kokë të tij. Dhe prapë auto-
kritikë, fjalë e fraza parazite... Atëhere dikush tha:
«Rubineti duhet mbyllur.» Kanë kaluar kohë. Rubi-
netin tani dikush duhet ta ketë mbyllur... Po
shprehja ka mbetur: «Si dikur Nishani në qyp...»

NJË PIKË LLAÇ

Qerimi, dhe Qeramudini, punonjës administrate, erdhën të bënin punën prodhuese në një godinë pesëkatëshe...

Është e kotë të teorizosh tani për punën prodhuese. Ata e kanë këtë më të qartë se shijen e kafesë turke që pinë çdo mëngjez në orën 9, në kafenenë pranë ndërmarrjes.

Shkurt fillon puna...

(Sa për dijeni, Qerimi mban aksidentalisht një kostum terital, kurse Qeramudini nuk e ka hequr akoma pardesynë e bardhë, me të cilën i ngjan tepër një doktori. Vetëkuptohet, nga pamja e jashtme.) Hm... Këtu ka llaç, ka tulla, ujëra... Po vetë populli a s'thotë se duhet parë puna, jo guna?..)

Pas një ndarjeje melankolike, Qerimi, i pari, ngjitet në katin e tretë. Aty fle vinçi, për të cilin është i tepërt edhe punëtori që e komandon herë pas here. Shoku Qerim qesh dhe jep urdhëra. Ndonjëherë, për të konkretizuar idenë e sakrificës, luan edhe ndonjë nga çelësat e shumë të që rrotullon nëpër duar. Sidoqoftë kjo s'duhet nënvleftësuar; mjafton të kujtojmë se kati i tretë është... kat i tretë,

pra s'është shaka, sidomos për Qerimin, që ka filluar të ankohet prej dhjemit...

Ç'bën ndërkaq shoku Qeramudin?

Ai punon në betonierë së bashku me punëtorin H. (Ky i fundit transporton gëlqere, e hedh atë në barkun e madh të betonierës, i hedh ujë, pastaj rërë, e gatuan, e derdh mbi sitë, pastron sitën e, sikur kjo të qe pak, mbush kova të tëra me llaçin e posagatuar.)

Hm... desh harruam. Edhe Qeramudini hedh në betonierë tri-katër lopata, (më falni, tri-katër maja lopate) me rërë...

Kalojnë dy orë. Tri...

Befas një pikë llaç bie mbi këpucët e Qeramudinit. Ky rënkon.

— Oooo! — dhe...

— E de se s'u bë qameti. — ja pret Kiu.

Qeramudini ka mirësinë të mos thotë asgjë.

— Ç'është? — arriti edhe Qerimi, që ka braktisur vinçin për t'i qenë kolegut pranë në këto momente.



— Një pikë llaç... thotë Qeramudini.

— Hë?... .

Dy Q. fillojnë të kullosin sytë nëpër konture e llaçit që ka zënë tani krejt majën e një... këpuce... Dy Q. fillojnë e diskutojnë për etimologjinë e fjalës «llaç»... .

— Hë shokë, si dukeni. Po teorizoni për punën fizike, eh... foli brigadjeri H. që po kalonte andej.

Dy Q. u panë në sy dhe Qerimi i çuditur tha:

— Po teorizojmë për punën fizike?!


— E pse jo, kur subjekt mund të bëhet edhe... një pikë llaç. Qeshi Kiu. — Eh, more shokë, është mirë të punoni për një kohë më të gjatë se koha e punës fizike këtu tek ne, që të mësoheni me llaçin e me tullat, me punën.

LETËR DINJITOZE

E hapa letrën pa shumë ceremoni. Aty shkruhej:
«Shoku Varg!

Poezinë tuaj «Mëngjez» e studjuam me kujdes.
Në tërësi ishte interesante dhe shkaktoi sensacion.
Po jemi të mendimit të mos e botojmë për disa arë-
sye «dinjitoze».

S'na duket plotësisht i justifikuar titulli i saj.
Pse të mos titullohej p.sh. «Mëngjez i bukur»?...
Pastaj përse të flitet në të vetëm për mëngjez? Për-



se i mohohet po kjo e drejtë p.sh. darkës ose...
edhe drekës?

Ju shkruani për pleqtë me qeleshe të bardha.
Pse ky përcaktim i prerë? Mos vallë s'ka qeleshe të
zeza? Po sikur dikush të ketë qenë pa qeleshe? Ju
ia impononi atë? Të kihet kujdes në këtë drejtim.
Përse i kushton tri strofa tablosë së fshatit dhe për
natyrën e bukur flisni vetëm në dy? Nuk ju duket
se ju mungon proporcioni i drejtë?

Gjithashtu gërmën «sh» e shkruani keq, dhe
ç'është më e keqja, e përdorni shpesh, rreth njëmbë-
dhjetë herë.

Kaq. Të fala shoqërore! Na shkruani, shoku
Varg...»

Qesha pak, pastaj e lexova letrën përsëri. Dhe
po mendoja:

«Ama kritikë e rëndë dhe me vend».

SOKRATI

Diçka si hije rrëshqet gjatë fasadës së errët të pallatit N. 19. Ngjit ngadalë shkallët e hyrjes B. e troket diku...

Një njeri i përgjumur, me një vështrim të çuditshëm, vëngërosh, zgjat kokën dhe e fton të hyjë brenda.

Dhoma është e mobiluar jo keq. Në ekranin e një «Adriatiku» heshtje. Dhoma flet. Diku në të majtë duket koka e ftohtë e një maqine qepëse «Baterflaj».

— Solle copën, hə? — thotë rrobaqepës Sokrati.

— Po... — Ai si hije duket hijerëndë, por i shqetësuar. — Poshtë i dua 27...

— Qartë! — Rrobaqepës Sokrati mbledh shpejt e shpejt copën, e lë diku mbi një tryezë dhe fillon befaz të fërkojë duart sikur pret diçka.

— Te gjunjët... pak zving, më kupton?

— E kam parasysh.

— Epo... — Ata afrohen më pranë njëri-tjetrit dhe shkëmbejnë ca dhjetëshe e pesëshe...


* * *

Përgjegjësi i repartit të rrobeve të gatshme, «shoku» Sokrat, ndezi një cigare, u shtri mirë e mirë në karrige.

Hapet dera dhe një vajzë e re hyn rrëmbimthi në zyrë.

— Prapë ti? — çirret befaz Sokrati. — Të thashë një herë...

— Shoku Sokrat, — këmbëngul vajza. — Sikur duhet parë kjo puna e qepjes së pantallonave, na mbetën dyqaneve, magazinave...



— Atë punë e di përgjegjësi, domethënë unë,
— thotë Sokrati me fodullëk. — Dera është atje.
Mund të dalësh.

* * *

Në mbrëmje Sokrati ulet në klube dhe, duke pritur në qetësi klientët që si hije hyjnë darkave në shtëpinë e tij për të qepur «me modë», rrëkëllen ndonjë kafe.

Deri para pak ditësh ky klub ishte vendi më i shenjtë për të. Aty klientët vinin vargan dhe ai të gjithëve u caktonte orët e marrjes së masave, të provave.

Dje Sokrati nuk u duk në klub fare. Sot gjithashtu. S'di gjë të sigurt, po ka mundësi të jetë turni i dytë, pasi ia kanë nuhatur avazin dhe e kanë kaluar në prodhim.

INTERVISTË ME FREDERIK BREGUN

Më kishin thënë se në familjen e tij vënia e emrave të fëmijëve ishte një çështje shumë e rëndësishme dhe njëkohësisht mjaft absolute. Emrat mendoheshin dy javë, një muaj, tre, para lindjes së fëmijës. Zgjidhej një emër vajze dhe një djali. Vetë Frederiku ishte tepër entuziast. Kur i thashë si shpjegohej ky interesim, më tha:

— Tradita është gjë e madhe. Edhe im atë ka pasur shije të çuditshme.

— Si quhej ai? — pyeta unë.

— Vasil... Mbiemrin në e kemi pasur Bregu. Por, siç dihet, atij ia vunë këtë emër dhe, kur u rrit e iu formua shije e çuditshme për emrat, ishte tepër vonë për të ndrequr gabimin. Unë reabilitova mbiemrin e një stërgjyshi, Martin. Më duket më evropjan.

— Babai juaj...

— Po. Babai im u mendua shumë për mua. Në fillim më quajti Zhan, pastaj deshi Tom, pastaj Viktor, derisa iu mbush mendja dhe më quajti Frederik.

— Pra ju quheni Frederik Vasil Bregu, më falni Frederik Martin?

— Po. Tamam ashtu, ndërsa fëmijëve u kam

vënë emra edhe më të bukur. Djalin e quajnë Daniel, pasi jam shumë i apasionuar pas «Robinsonit» të Daniel Defosë.

— Daniel Frederik Martin...

— Ndërsa vajza ka një emër italian.


— Si?

— Bianka. Ju pëlqen?

— Është «meravilios»...

Po kam dhe të tjerë dhe nxori nga xhepi një listë të gjatë dhe filloi t'i lexonte.

— Fëmijës që pres të më lindë, do t'i vë një



emër të madh, Volfang. Ju pëlqen? Tingëllon apo jo?

— Ndërsa, po lindi vajzë?

— Mikaela...

— Bukur.

— Ç'të mbetet nga lista pa u vënë, do t'ua shpërndaj shokëve e farefisit. Fëmijëve do mundohem t'u edukoj të njëjtën shije të lartë... nipërve do t'u vë emra edhe më të bukur. Ka ende emra të papërdorur, italianë, gjermanë, francezë të papërdorur.

— Ashtu është, — i thashë — se ata italianët e francezët janë me dhjetëra milionë...

Po ai s'më dëgjoï dhe vazhdoi të lexonte:

— Ana-Maria, Xhori, Adriana, Bob, Gerhard...

ÇUDI, ÇUDI!

— Mos e harro porosinë e fundit — i foli Maku shkesit që bashkë me një mike të së ëmës po pre-gatiteshin të kapërcenin prakun. — Televizori e la-vatrici ja janë brenda. Frigorifer s'kam ose... s'kemi, por do ta marrim edhe atë. E theksoj, do ta marrim...

Përballë tij pasqyra i dha si papritur reflekti-min e fytyrës që kishte filluar të plakej.

«S'jam i keq, mendoj, dhe, po të mos isha mo-dest, do ta quaja veten «simpatik». Si i perëndoi sytë edhe një herë para pasqyrës, hyri në kuzhinë.

«Djalë i vetëm... Me qumësht dallëndysheje në shtëpi... I pashëm. As duhan, as alkool. Ka arë-sye refuzimi?...»

Me këtë ëndërr të bukur në kokë u mbështet në divan dhe mbylli sytë.

Koka dhe divani. Koka me një ëndërr të bukur, divani me një kurriz të butë.

Ndoshta kjo përjasje, pse jo e goditur esteti-kisht, i imponoj atij një gjumë të menjëhershëm, të ëmbël.

Pas një ore shkesi dhe shoqëruesja e tij u kthyen. Fytyrat e tyre nuk premtinin asgjë të mirë.

— ...uk do — belbëzoi shkesi. (I merrej pak goja dhe gërmën «n» thujse s'e shqiptonte fare).

— Kush? — Ai sapo ishte përmendur e i dukej vetja si në ëndërr.

— Ajo. . . -- tha shkesi.

— Pse?

— ...uk e di. I ati ishte dakord. Ajo uk do. .

— Po pse? — pyeti prapë Maku.

— Çupat kanë naze — u hodh mikja e së ëmës. Pastaj siç po bëhet tani rinia, s'merret vesh do apo s'do. Po rëndësi ka që familja është dakord. Të tjerat rregullohen më vonë.

Makun s'e mbante vendi. Ai e kapi shkesin për krahu dhe i lëshoi në fytyrë një breshëri pyetjesh:

— Mos do ndonjë tjetër? Ka gjë me atë studentin që e quan shok? Di gjë i ati?

— Ai kishte dyshime! — tha shkesi.

— Me atë studentin?

— Po.

— Ti bën mirë të bisedosh vetë me vajzën — propozoi mikja.

— Ë? — Maku u mendua një çast. — E di se nuk e ke keq ti?

— ...uk e ka keq — belbëzoi shkesi:

— Po, por. . .

Ata u mblodhën kokë më kohë. Ai kishte biseduar njëherë me të. Madje kishte guxuar e ia kishte përmendur fejesën tërthorazi. Vajza kishte buzëqeshur. Ai ruante në vetëvete një farë shprese të mugët.

— Unë do të bisedoj me të, por kjo s'do të thotë se ju e mbaruat misionin — tha më në fund Maku.

— atyrisht — nxitoi t'i përgjegjej shkesi.

* * *

Po rastësia shënoi një fund të parakohshëm. Të nesërmen, kur po përgatitej të nisej në zyrë, te dera u përplas me shkesin.

— Aajo po shkon...

— Hë! Kush?


— Ajo... ga stacioni...

Makut iu zverdh lëkura e fytyrës. Iu duk sikur do të rrëzohej nga çasti në çast. Mbështeti dorën mbi supin e shkesit dhe mezi belbëzoi:

— C'të bëjmë?

— Vetëm ti mund t'ia kthesh mendjen. Shkoji pas...

Maku u gëlltit. Çanta i ra nga dora mbi këpuçët e shkesit. Pas pak nëpër rrugën drejt stacionit



gjithkush mund të vinte re një figurë 35 vjeçare me flokë të shpupuritur, që vraponte si i çmendur drejt stacionit. Në stacion njerëzit s'numëroheshin.

— Hm... Mimoza! — mermëriti Maku, kur pa se vajza ishte ulur në një nga stolat e stacionit dhe priste.

— Hë? — ia pat ajo thatë. — Po shkon me shërbim?

— Jo, jo... ashtu kot, po ti?

— Unë po shkoj në C.

— Shëtitje? Ku? Me kë? Përse?

— Në C. Me një shok. Babai s'pranoi ta merrja... dhe...

— Ë? Pse ti...

Maku s'arriti të thosh asgjë. Ajo i bëri një përshëndetje me dorë dhe iku. Te dera e vagonit më të afërm u takua me një djalë. Të dy hipën në tren.

Ai mbeti aty si hu gardhi. Treni u nis. Dhe pak nga pak iu zhduk nga sytë. Stacioni po qetësohej. Një plak simpatik me rrobet e punonjësit të hekurudhës iu afrua dhe i tha duke qeshur:

— Të la...

— Hë?

— Treni.

«Treni jo, dikush tjetër,» tha Maku me vete.

— Më fal, — vazhdoi plakun, duke i treguar daljen — do të mbyllim stacionin...

Maku filloi të ecte. Fytyra i kishte marrë një çehre të zbehtë.

«Djalë i vetëm, mermëriste, me qumësht dallëndysheje në shtëpi. As duhan, as alkool... Çudi, çudi!»


MIKROKOMEDI

Drejtori i shtëpisë së kulturës u kthye nga ma-
soviku edhe e pyeti:

— Hë, si duket?

— Asnjë... — tha ky i mërzhitur.

— Qysh?



— Mjerisht. . .

— Asnjë, asnjë?

— Po.

Drejtori, përplasi duart me zemërim.

— Po ti? — i sokëlliu ai masovikut.

— Ç'faj kam unë?

— Edhe çuditësh?

— Pse?

— Qysh pse? Kjo s'ka ndodhur asnjëherë. A u afishuan lajmërimet?

— Posi.

— Ma jep tekstin e lajmërimit.

Masoviku nxori nga xhepi një copë letër të zhubravitur. Ia dha drejtorit.

— Jo keq — u përmend ky. — Atëhere përse ky indiferentizëm? Verifiko të lutem orën e takimit.

— Ah, në rregull fare — nxitoi të përgjegjej masoviku.

Drejtori ndezi një cigare. U kollit pa forcë. Hapi derën e sallës së mbledhjeve dhe hodhi një sy brenda. Qetësi. Asgjë e gjallë. Po, karriget ishin rreshtuar bukur. Në tryezën e lektorit ishin vënë lule. Çka, jo keq. Prgatitjet ishin të goditura.

— Shoku drejtor! Shoku drejtor! — e zgjoi prej mendimeve zëri i shqetësuar i masovikut.

— Hë, ç'është?

— Erdhi lektori, shoku Q. . .

— Dili përpara!

— Çfarë?

— Prite pra, a kupton?

— Po si t'ia bëjmë?

— Shko, shko!

Drejtori vazhdoi të thithte cigaren. Lektorit e masoviku u ngjitenë dalëngadalë lart.

— Mirë se ardhe, shoku Q. . . — foli drejtori dhe i shtrëngoi dorën lektorit.

Masoviku ishte pulitur.

— Hm. . . — tha drejtori.

— Unë jam gati — u dëgjua zëri i çuditshëm i lektorit.

Drejtori e tërhoqi lektorin drejt sallës mikpritëse dhe i tha:

— Qetësohu pak. Gjëra taktike.

Masoviku i bëri me shenjë.

— Hë! — foli drejtori.

— Kam një mendim.

— Një mendim?

— Një mendim të mirë?

— Pa hë.

— E çojmë në sallën e studimit?

— ? . . .

Drejtori shtrembëroi buzët. Ndezi përsëri cigare.

— Mirë — tha më në fund.

Masoviku i bëri lektorit shenjë me kokë. Drejtori i tha se kishin ndërruar sallën e takimit. Ata hynë në sallën e studimit sipas etiketës. Në fillim lektori, pastaj drejtori e pas tij masoviku.

Në sallë kishte qetësi. Po studjohej. Pak veta i çuan kokët lart.

Drejtori shikoi masovikun. Ky përtypej dhe lëvizte duart kuturu. Numri i kokëve kureshtare u shtua.

— Me siguri ndonjë vërejtje lidhur me ata që pinë këtu duhan — i pëshpëriti njëra kokë tjetrës.

Drejtori qeshi për formë dhe filloi:

— Shokë! — Zëri i tij ishte i butë e thujse lu-

tës. — Shoku Q... do t'ju flasë, ashtu siç jeni lajmëruar, për disa probleme të...

Thua jse të gjithë i ngritën kokët. Sy të panumërt iu drejtuan «miqve». Disa folën, disa shprehën habinë me gjeste!

— Ju lutem, — u ngërdhesh masoviku — ju lutem, pak qetësi!

Lektori nxori ca fletë të daktilografuara. Qeshi dhe u përgatit të fliste.

Megjithatë s'mund të thuhet se drejtori dhe inferiorët e tij nuk mendojnë për organizimin sa më të mirë të aktiviteteve të shtëpisë së kulturës. Sa për taktikën, kjo është çështje tjetër...

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Ai dhe pikëllimi	3
Natën e mirë, shoku Kozma!	6
Autoritet dhe autoritet	9
Tri ditë me Sokolin	12
Djali i profesorit	16
Fejtonisti betohet	19
Lutet babai «ideal»	22
Në klubin e kooperativës	25
Në pritje... ..	28
Historia e shkurtër e një rubineti	32
Një pikë llaç.	34
Letër dinjitoze	37
Sokrati.	39
Intervistë me Frederik Bregun	42
Çudi! Çudi!	45
Mikrokomedi	49

Redaktore: *Lumturi Prizreni*
Piktor: *Hasan Koka*

Tirazhi 4000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NENTORI» — Tiranë, 1974